



VENDIM

Nr.58 Datë 23.04.2015

PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË “GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBER” SH.P.K.NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9 dhe nenit 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “P”; 5 pika 1 gërma “P”; 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBER” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBER” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm, Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacioni financiar dhe fiskal (Neni 9, pikat 1, 2, 3) është i plotësuar tërësisht.
- Te dhënat specifike sipas tipit të Licensës (neni 9 pika 4/9 germat a,b dhe c) janë plotësuar tërësisht,
- Te dhënat specifike sipas tipit të Licensës (neni 9 pika 4/9 germat a,b dhe c) janë plotësuar tërësisht,

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë **“GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBER”** sh.p.k, në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



VENDIM

Nr.58 Datë 23.04.2015

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E
GJELBER” SH.P.K.NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____